

V E N D I M

Nr.421, datë 21.7.1999

PËR CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Komisionit të Përbershëm për Mjetet e Informimit Publik

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Shpërblimi mujor i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) është 30 për qind e pagës mujore të Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

Kjo masë shpërblimi është e vlefshme edhe për rastet kur një anëtar i këtij Këshilli është njëkohësisht edhe punonjës i administratës së KKRT-së, me kusht që shpërblimi së bashku me pagën mujore të mos kalojë nivelin e pagës së zëvendëskryetarit.

Shpërblimi mujor i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zbatohet mbi bazën e pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit dhe në veprimtaritë vendimmarrëse të tij. Për këtë qëllim, Këshilli përcakton në rregulloren e funksionimit së vet masën e shpërblimit për çdo mbledhje. Kur pjesëmarrja në mbledhje është e plotë, pagesa do të jetë e barabartë me masën e përcaktuar në paragrafin e parë të pikës I të këtij vendimi. Për çdo mungesë, nga kjo shumë zbritet kuota e përcaktuar në rregulloren e Këshillit.

II. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë që nga data e zgjedhjes së tyre si anëtarë të KKRT-së.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.